



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më .12.2025

**MBLEDHJA Nr. 50,
Datë 15.12.2025, ora 09:00
e Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 15.12.2025, ora 09:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 50 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2026.
2. Mbi përcaktimin e listës së tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për vitin 2026.
3. Mbi miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve me përparësi për vitin 2026.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “AGE ERZEN” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE, për vendosjen e aseteve të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.
5. Mbi shfuqizimin e vendimit nr. 216, datë 18.09.2025, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “D I E Z E L A” sh.p.k.”.
6. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI
Petrir AHMETI**